# 2009








МЦМС

# RAPORT VJETOR

# Përmbajtja

3 Vizioni dhe misioni
3 Qëllimet dhe metodat
4 Mesazh nga udhëheqësia
5 Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë
5 Modernizimi i arsimit
6 Maqedonia pa diskriminim
8 Ndërmarrje të zhvilluara të vogla dhe të mesme – udhëheqja me MRFP
9 Zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rural
9 Zhvillimi lokal i bashkësive
10 Furnizimi me ujë i komunës së Jegunovcit
11 Sundimi i mirë, pjesëmarrja dhe politika të drejtuara drejt njerëzve
11 Sundimi i mirë në Maqedoni
13 Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike
13 Zhvillimi institucional i shoqërisë civile
15 Diverisifikim i pranuar kulturor, ndërvarësi dhe dialog
15 Maqedonia – model për dialog të kulturave
16 Proces i mbështetur eurointegrues dhe bashkëpunimi rajonal
16 Menaxhimi me rrjetin ballkanik për zhvil limin e shoqërisë civile
17 Partneriteti, marrëdhëniet me opinionin dhe mbështetja
17 Marrëdhëniet me aktorët
17 Marrëdhëniet me opinionin
18 Mbështetja – MCMS i qëndrueshëm
18 Fushata për mobilizimin e fondeve
20 Organizata
20 Këshilli
20 KD
21 Personeli
21 Zyra ekzekutive
22 Mendimi i pavarur i revizorëve
23 Raporti financiar 2009

## VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni i MCMS është paqe, harmoni dhe prosperitet i njerëzve si në Maqedoni dhe në Ballkan dhe globalisht.
MCMS vizionin e vet e bazon në parimet universale të shoqërisë civile dhe demokracisë pjesëmarrëse, sundimin e të drejtës, zhvillim i barabartë dhe i qëndrueshëm socio-ekonomik, jodhuna, respekti dhe ndërvarësia dhe diverisfikimi kulturor.
Misioni i MCMS është të udhëheqë dhe të ndryshojë me zgjidhje të reja dhe alternative problemet dhe sfidat shoqërore, të cilat ndikojnë te aktorët tjerë dhe të cilat inkuadrohen në rrjedhat kryesore.

## QËLLIMET DHE METODAT

Qëllimet afatgjate të MCMS janë:

- Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë;
- Diversifikim, ndërvarësi dhe dialog i pranuar kulturor;
- Zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rural;
- Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara nga dhe drejt njerëzve;
- Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike civile, që ndikon në politikat publike;
- Proces i mbështetur eurointegrues me bashkëpunim të forcuar rajonal;
- MCMS, organizatë e pavarur me kredibilitet, e aftë për partneritete të fuqishme dhe efektive dhe aleanca të bazuara në barazi (në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar);
- MCMS është organizatë atraktive dhe rinovuese e cila mëson, me rrënjë lokale dhe vështrim global.

MCMS aktivitetet i realizon nëpërmjet metodave programore dhe organizative:

- avokimi (informimi; ngritja e vetëdijes dhe edukimi; krijimi dhe ndikimi mbi politikat; përcjellja dhe kërkimi i përgjegjësisë);
- mbështetja zhvillimore (kapacitete dhe infrastruktura);
- mbështetja sociale-humanitare;
- udhëheqje dhe zbatim.

# MESAZH NGA UDHËHEQËSIA

Në vitin 2009 ndjeheshin efektet negative të krizës ekonomike globale, ndërsa nga fundi i vitit u paraqitën shenjat e para të përmirësimit. Në Maqedoni efektet negative nga kriza ishin më të vogla dhe të vonshme. Një nga efektet e krizës ekonomike globale është zvogëlimi i buxheteve të qeverive të huaja për bashkëpunim zhvillimor.
Vazhduan përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për integrim në Bashkimin Evropian. Vitin e shënuan liberalizimi i vizave dhe raporti pozitiv i Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë dhe rekomandimet për fillimin e negociatave për anëtarësim, që nga fundi i vitit megjithatë nuk u miratua nga Këshilli i ministrave të BE, me prolongimin e vendimit për këtë çështje për vitin e ardhshëm 2010.
MCMS në vitin 2009 kishte vëllim të përgjithshëm (portfolio) prej 27 projekteve dhe buxhet prej 88 milionë denarë. Realizimi i portoflios ishte shumë i mirë – 84% nga plani, ndërsa të buxhetit 96%. Buxheti në vitin 2009 ishte për 17% më i lartë se në vitin 2008.
Në këtë periudhë filluan programet Zhvillimi institucional i shoqërisë civile (IRG) dhe Modeli për dialog të kulturave (MDK). Përfundoi zbatimi i programit Zhvillimi lokal i bashkësive (LTZ), Fushata për mobilizimin e fondeve (KMF), ndërsa në fazë përfundimtare është edhe programi Furnizimi me ujë i komunës së Jegunovcit (VOJ) që do të përfundojë në vitin 2010.
MCMS në vitin 2009 iu përkushtua vërtetimit të dy propozim ligjeve: Ligji për shoqata dhe fondacione dhe Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji për shoqata dhe fondacione është pjesë e rëndësishme për zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me sektorin civil. Aktivitet i rëndësishëm janë edhe forumet në bashkësi të cilat realizohen në kuadër të programit DUM, në komunat Aerodrom, Manastir, Resnjë, Berovë, Radovish, Konçe dhe Karbinc.
Vitin e shënoi edhe regjistrimi i dy rrjeteve, iniciator dhe themelues i të cilave ishte MCMS: Maqedonia pa diskriminim (MBD) dhe Rrjeti ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile (BCSDN). MCMS është zyrë ekzekutive për BCSDN, ndërsa Tanja Hafner-Ademi nga MCMS u zgjodh për drejtor ekzekutiv i rrjetit.
MCMS pati komunikim intensiv, me pjesëmarrje në punën e Këshillit nacional për integrime evropiane dhe veçanërisht me kontributin aktiv për vendosjen e Komitetit të përbashkët konsultativ të shoqërisë civile BE-RM, nga fundi i shtatorit e mbajti mbledhjen e vet konsultative në Bruksel.
Në pjesën e marrëdhënieve me opinionin, MCMS tërësisht e rregulloi dhe e promovoi pamjen e re të ueb faqes së vet, e cila është më informative dhe teknikisht e avancuar, që hasi në pranim pozitiv te shfrytëzuesit.
Aleksandar Krzhallovski u zgjodh për drejtor ekzekutiv në tetor 2010, me çka u kompletua Bordi i drejtorëve të MCMS.



Sasho Klekovski
Drejtor i parë
ekzekutiv





Aleksandar
Krzhallovski
Drejtor ekzekutiv



# KOHEZIONI SOCIAL DHE ZVOGËLIMI I VARFËRISË

## MODERNIZIMI I ARSIMIT

Qëllimi i programit është modernizimi i shkollimit fillor në pajtim me standardet e BE.

Gjatë vitit 2009 u meremetuan pesë shkolla fillore në bashkësitë rurale dhe atë në f. Konçe (Konçe), f. Cërnilishtë (Dollneni), f. Nova Maalla (Vasilevë), f. Kukureçan (Manastir) dhe f. Dobrushevë (Mogillë). Ky është një nga donacionet e rralla private, ndërsa e siguroi Sokotab dhe parnerët e tij. Ky lloj bashkëpunim zgjat tre vjet. Projektet u realizuan në bashkëpunim me administratat komunale dhe drejtoritë e shkollave.

### KUSHTE MË TË MIRA PËR PUNË PËR RRETH 1.2000 NXËNËS DHE ARSIMTARË

Për 1.048 nxënës dhe 141 të punësuar në pesë shkolla në mjediset rurale, mësimi zhvillohej më lehtë duke iu falënderuar projekteve për modernizimin e arsimit që gjatë vitit 2009 i realizoi MCMS.
Shkollat fillore Goce Dellçev në f. Konçe dhe në f. Nova Maalla (Vasilevë) janë dy prej pesë shkollave ku MCMS e financoi rekonstruimin e pjesshëm.
Në shkollën në Konçe, u bë demontimi i dritareve dhe dyerve të vjetra dhe vendosja e të rejave. Nxënësit, arsimtarët dhe prindërit janë shumë të kënaqur me kushtet e përmirësuara. "Fëmijët kalojnë mjaft kohë në shkollë dhe qëndrimin atje duhet ta kenë të këndshëm", thotë Dançe Kostadinova, nëna e Kristijanit, nxënës i klasës së katërt. "Djali im është i mahnitur nga ndryshimet", shton ajo, "dritaret i kanë më të bukura edhe se nga shtëpia", thotë ajo me buzëqeshje. Unë kam dy vajza në shkollë", u ndërlidh Slavica Vuçkova, "në klasën e dytë dhe të katërt. Dallimi është shumë i dukshëm, nuk ka ushujë, fëmijët më rralë sëmuren, bile edhe ata që ulen afër dritareve, që më herët nuk ishte vend i këndshëm, tani nuk kanë problem", thotë Slavica.
Prindërit e fëmijëve që mësojnë në shkollën në f. Nova Maalla kanë problem tjetër. Oborri i shkollës i parrethuar e kërcënon sigurinë e fëmijëve të tyre. Tani, me mbështetjen e MCMS është ndërtuar muri rrethues i oborrit shkollor. Të inkuadruarit nuk e fshehin kënaqësinë nga punët e kryera. "Punën e përfunduam shumë shpejt dhe me sukses në kënaqësi të gjithë prindërve, nxënësve dhe arsimtarëve", thotë Gjorgji Conev, këshilltar i komunës së Vasilevës. "Reagimet pozitive nuk mund të përshkruhen me fjalë. Ky problem na mundonte shumë vite sepse fëmijët në shkollë nuk ishin të sigurt, ishin të ekspozuar në komunikacionin në rrugë, por kjo tani është e kaluar. Të gjithë palët e inkuadruar bashkëpunonin me sukses, procesi ishte në partneritet dhe gjithnjë ishim në rrjedhë me atë çfarë ndodhte, duke përfshirë edhe procedurën për furnizim dhe zgjedhjen e furnitorit. Arritëm ti përfundojmë të gjitha obligimet e ndërmarra. Komuna pati edhe pjesëmarrjen e saj në projektin e rregullimit të oborrit dhe mbjelljen e gjelbërimit, e tani përfundojnë edhe shtigjet për këmbësorë", shtoi Conev.



Me drirate e reja në SHF "Goce Dellçev" në Konçe, nuk ka ushujë dhe fëmijët më rrallë



## MAQEDONIA PA DISKRIMINIM

Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i rrethinës mbështetëse për mundësi të barabarta të gjithë njerëzve, gjegjësisht jodiskriminimi në Maqedoni.

Gjatë këtij viti u realizua një vizitë studimi në Vjenë, Austri, ku morën pjesë 10 përfaqësues të sektorit qeveritar dhe civil, ku patën mundësi t'i vizitojnë institucionet relevante shtetërore në Austri, si dhe organizatat qytetare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Gjithashtu u realizuan katër trajnime për jodsikriminim, ku morën pjesë 81 pjesëmarrës. Trajnimet iu dedikuan organizatave të qytetarëve, koordinatorëve për mundësi të barabarta nga pothuaj të gjitha ministritë, përfaqësues të Qendrave për punë sociale, ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, si dhe për përfaqësuesit nga Byroja për siguri dhe persona udhëheqës të MPB-s. Në kuadër të projektit u ribotua Doracaku për jodiskriminim, ndërsa u përgatit dhe u publikua raporti hulumtues "Barometri për mundësi të barabarta". U përgatit edhe analiza e standardeve dhe shembujve të praktikës së mirë në zhvillimin e legjislativës anti-diskriminuese. Më 16 qershor 2009 u mbajt kuvendi themelues i Aleancës Maqedonia pa diskriminim, i cili funksiononte si lidhje joformale nga marsi i vitit 2008. Themelues të Aleancës janë 11 organizata qytetare. Në këtë periudhë u përgatit edhe Plani strategjik i aleancës Maqedonia pa diskriminim 2010-2012.

## "BAROMETRI PËR MUNDËSI TË BARABARTA"

MCMS e publikoi raportin nga hulumtimi i quajtur Barometri për mundësi të barabarta. Hulumtimi ishte përqendruar në: perceptimin e diskriminimit, në përvojat dhe luftën kundër diskriminimit, në njohjen e të drejtave si dhe qëndrimin ndaj mundësive të barabarta për punësim.
Sipas rezultateve, diskriminimi mbi bazë partiake llogaritet për formë më të shpeshtë të diskriminimit në Republikën e Maqedonisë (78%), pastaj vijon diskriminimi mbi baza etnike (55%) dhe diskriminimi mbi bazë të moshës (48,5%).
"Perceptimet jo gjithnjë përputhen me gjendjen faktike", tha prof. Violeta Petroska Beshka, një nga autoret e raportit. "Por, pa dallim, ato janë shumë të rëndësishme".
Qytetarët pohojnë se ndihen këndshëm lidhur me llojllojshmërinë në rrethimin e tyre, vetëm nevoja për distancim social nga personat me orientim homoseksual është shumë i shprehur.
Pothuaj 33,5 % nga të anketuarit janë deklaruar se gjatë vitit të kaluar kanë qenë viktimë e diskriminimit ose keqtrajtimit. Shkalla e diskriminimit në RM është shumë e lartë nga shkalla mesatare e diskriminimit në vendet e BE-së.
Në një pjesë të veçantë të raportit është bërë analizë e të dhënave nëpër prizmin e përvojave të deritanishme ose siç tha prof. Mirjana Najçevska, autorja tjetër e raportit, "përpjekje që të probematizohet imazhi nga raporti". Ajo bëri edhe lidhje mes të dhënave nga raporti dhe përpjekjet aktuale për miratimin e Ligjit për jodiskriminim dhe formimin e organit të veçantë për barazi.




Nga e majta: Violeta Petroska-Beshka, Natasha Postollovska, Alekandar Krzhallovski dhe Mirjana Najçevska në promovimin e raportit

Anketa është realizuar nga ana e Qendrës për të drejta të njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve, në bashkëpunim me Brima nga Shkupi në ekzemplar prej 1.606 të anketuarve.

## U THEMELUA ALEANCA MAQEDONIA PA DISKRIMINIM

Më 16 qershor të këtij viti u mbajt kuvendi themelues i Aleancës Maqedonia pa diskriminim. Vendimin për formalizimin është rezultat i nevojës nga veprimi më i organizuar në fushën e promovimit të mundësive të barabarta dhe mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë. Maqedonia pa diskriminim ka për qëllim të kontribuojë drejt shoqërisë së drejtë, pa diskriminim, ku të gjithë njerëzit i gëzojnë mundësitë e barabarta dhe përfitimet nga disversifikimi.

"Dobia nga formalizimi nuk është drejtuar vetëm drejt organizatave qytetare, e as drejt punës së organeve shtetërore, por drejt të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë", thotë Muhamed Toçi, nga HDZR "Meseçina". "Maqedoninë pa diskriminim e përbëjnë organizata me përvojë prapa të cilave qëndron puna shumëvjeçare në luftën kundër diskriminimit mbi baza të ndryshme. Kjo përvojë dhe shkathtësitë dhe njohuritë e tyre d të kontribuojnë që Aleanca në mënyrë më efikase të ballafaqohet me të gjitha sfidat nga kjo sferë".

Në kuvendin themelues u zgjodh përbërja e mandatit të parë të Kuvendit të Aleancës Maqedonia pa diskriminim. Themeluesit e sollën Statutin, ndërsa Kuvendi e miratoi propozim-programin dhe i zgjidhi anëtarët e Këshillit drejtues dhe mbikëqyrës.

Disa ditë më vonë, më 18 qershor 2009 u mbajt edhe mbledhja konstitutive e KD. Në këtë mbledhje për kryesues të KD u zgjidh Muhamed Toçi, ndërsa për zëvendës kryesues Mirjan Najçevska. Zyra koordinuese gjendet në Polio plus, ndërsa Natasha Postollska u caktua për u.d. drejtor ekzekutiv i Aleancës Maqedonia pa diskriminim.

Nga fundi i vitit 2009, MBD formoi Trupin nacional koordinativ ku përveç organizatave qytetare anëtarë të Aleancës dhe jashtë saj, janë anëtarë edhe përfaqësues të institucioneve qeveritare, deputetë nga parti të ndryshme politike, ekspertë të dëshmuar nga fusha e demokracisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Themelues të Aleancës janë: Asociacioni për iniciativa demokratike nga Gostivari, El Hilal nga Shkupi, Qendra maqedonase për të drejta të grave nga Shkupi – Shelter qendra nga Shkupi, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar nga Shkupi, Këshilli nacional i grave të Maqedonisë nga Shkupi – LOGM nga Shkupi, Polio plus-lëvizja kundër handikapit nga Shkupi, Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi nga Shkupi, Shoqata bamirëse dhe humanitare e romëve "Meseçina" nga Gostivari, HOPS – opsione për jetë të shëndoshë nga Shkupi, Qendra për të drejta të njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve nga Shkupi dhe "Universiteti" Mosha e tretë nga Shkupi.



Nga themelimi i Kuvendit të Aleancës MBD

## NDËRMARRJE TË ZHVILLUARA TË VOGLA DHE TË MESME – UDHËHEQJA ME MRFP

MCMS i kryen të gjitha punët udhëheqëse, profesionale dhe administrative për Fondacionin Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP), si Institucion për udhëheqje.

Në vitin 2009 u paguan kredi me vlerë prej 229.492.150 denarë (rreth 3,7 milionë euro) ndaj 931 klientëve. Shuma e paguar për kreditë është për 4% më shumë në krahasim me atë që ishte planifikuar, ndërsa numri i përfshirjes së klientëve është 93% në krahasim me numrin e planifikuar. Me këto kredi janë mbështetur 2.024 vende pune, ndërsa me shfrytëzimin e kredive në drejtim të zgjerimit të veprimtarisë së tyre, këto ndërmarrje planifikojnë të punësojnë 546 punëtori të ri. Me këtë të fundit, numri i përgjithshëm i arritur i shfrytëzuesve deri më 31.12.2009 është 7.253, me çka janë mbështetur gjithsej 12.877 vende të përhershme pune dhe 2.847 vende të planifikuara pune. Si edhe në periudhën paraprake, pjesa më e madhe e mjeteve janë plasuar përmes mikro kredive (huazimi tip 3), me të cilin janë përfshirë 909 mikro sipërmarrës, ose 97% nga numri i përgjithshëm i klientëve. Pagesa e kredive nga ana e ndërmjetësuesve financiar drejt MRFP është bërë në tërësi.



Shfrytëzues i kredisë: Xhaxhi Boge nga Katllanova në punëtorinë e tij

Kreditë janë paguar përmes ndërmjetësuesve të akredituar financiar: NLB Banka Tutunska, IK banka, kursimorja Mozhnosti dhe fondacioni Horizonti (për herë të parë si ndërmjetësues i akredituar financiar). Me ndërmjetësuesit e përmendur financiar në fund të vitit 2009 MRFP i nënshkroi marrëveshjet kornizë financiare, me të cilat, mes risive të tjera, janë vendosur produkte të reja kreditore të dedikuara për kreditimin e IT, prodhimtarinë organike, turizmin, biznes fillestarët dhe për projekte të volitshme për financim nga IPARD.

MRFP siguroi mbështetje programore dhe organizative për zbatimin e aktiviteteve programore të LOE, OEMVP dhe të Grupit për zhvillimin e nënsektorit domatja dhe speci për periudhën 2009-2011. Në bashkëpunim me Qendrën për zhvillimin e bizneseve të reja (BSC), MRFP e përgatiti dhe e promovoi raportin "Sipërmarrja në Maqedoni", si pjesë nga hulumtimi më i madh për sipërmarrjen në botë (GEM). MRFP bashkë me organizata të tjera e organizoi Ditën evropiane të sipërmarrësit dhe zgjedhjen e Sipërmarrësit të vitit.

Në maj të vitit 2009 u realizua rejtingu i dytë kreditor i MRFP nga ana e Mikrofinanca nga Italia, që bazohej në të dhënat nga 2006-2008 si dhe vitet vijuese financiare pas rejtingut të parë në vitin 2006. Me raportin MRFP fitoi rejtingun kreditor BB+ (2006: BB).



# ZHVILLIM I QËNDRUESHËM LOKAL DHE RURAL

## ZHVILLIMI LOKAL I BASHKËSIVE

Qëllimi i programit është zhvillim  nxitur lokal i bashkësive rurale dhe të margjinalizuara përmes pjesëmarrjes së rritur dhe forcimit organizativ.

Gjatë vitit 2009 me programin u realizuan trajnime: për udhëheqje me ciklin e projektit dhe për udhëheqje me resurse njerëzore. U mbajtën disa punëtori: për metodologjinë për vlerësime dhe caktimin e tatimeve lokale dhe taksa për përfaqësuesit e administratës komunale të 13 fokus komunave të programit LRZ; për vendosjen e NASSAP, për definimin e prioriteteve për reforma në sektorin komunal, për kontrollin e ndotjes së ujërave të zeza, për indikatorët kryesor për realizim (KII), për GIS zgjidhjet në NKP dhe punëtori për anëtarët e Komisionit për furnizim me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza.
Gjithashtu u organizuan edhe 4 punëtori rajonale për gjendjet me menaxhimin me resurset njerëzore në NJVL dhe u krijua baza e të dhënave për personat përgjegjës pranë NJVL për menaxhimin me resurset njerëzore, u realizuan edhe aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve të këshillave të bashkësive lokale, si dhe aktivitete për forcimin e kapaciteteve organizative të Fondacionit për mbështetje dhe zhvillim, Prilep.

Tetë komunave iu dhanë grante për aktivitete për avancimin dhe modernizimin e shërbimeve komunale, u organizua Vizitë studimi NKP-ve në Shqipëri dhe Serbi, si dhe u organizua Konferenca rajonale për komisionin rregullativ.

Këtë vit për herë të tretë  botua Adresari i komunave në Republikën e Maqedonisë, ndërsa për herë të paru u punua edhe në përgatitjen e Profilit të organizatave, institucioneve dhe projekteve për zhvillim rural.
Në kuadër të projektit “Forumet në bashkësi” (në komunën e Karbincit) u realizuan tre projektet e zgjedhura nga ana e Forumit: Rregullimi urban; Terrene të vogla sportive dhe Fusha për fëmijë.

## ADRESAR I KOMUNAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) bashkë me Bashkësinë e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (ZELS) për herë të tretë e përgatitën Adresarin e komunave në Republikën e Maqedonisë.
Adresari i ri ofron informata interesante për të gjitha 84 komunat dhe qytetin e Shkupit. Në adresar përveç kontakteve themelore, janë prezantuar edhe të dhëna demografike, vendosja strukturore e komunës dhe të dhëna për institucionet që janë nën kompetencat e komunës. Adresari ofron të dhëna për buxhetin e komunës, për NKP ekzistuese, si dhe të dhëna për projektet e realizuara, në rrjedhë dhe të planifikuara. Adresari është botuar në formë elektronike në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.



## FURNIZIMI ME UJË I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Qëllimi i programit është të sigurohet qasja deri te sasitë e mjaftueshme të ujit të shëndoshë për pije në bashkësitë e komunës së Jegunovcit. Fokusi i këtij programi është të përmirësohet furnizimi me ujë në 11 fshatra nga ish komuna e Jegunovcit, si dhe në f. Ozormishtë të komunës së Zhelinës.
Gjatë vitit 2009 u realizuar dy projekte: “Infrastruktura për furnizim me ujë të komunës së Jegunovcit” dhe “Fushat për forcimin e vetëdijes publike për furnizimin me ujë”.

### “LLOGARI E PASTËR – UJË I SHËNDOSHË”

“Llogari e pastër – ujë i shëndoshë” ishte slogani i fushatës së MCMS për forcimin e vetëdijes për furnizimin me ujë të komunës së Jegunvcit.
Fushata kishte për qëllim ta ngrejë vetëdijes publike për nevojën nga kyçje individuale me matës dhe pagesa e ujit që shfrytëzohet nga sistemet e reja të ujësjellësit në komunën e Jegunvcit.
Fillimin e fushatës e shënuan orët e para edukative për nxënësit nga shkolla fillore “Shemshovë” në fshatin Zhillçe në temën “Ujë do të thotë jetë”. Nxënësit patën mundësi të njoftohen dhe të bisedojnë për ujin e planetit të Tokës, lëvizjen e saj, pse na nevojitet ujë i pastër, pasojat nga uji i dëmshëm, përdorimi i ujti etj. Në orët e para edukative morën pjesë 58 nxënës nga klasa e pestë deri në klasën e tetë.
Paralelisht me orët edukative u shpërnda edhe materiali promovues nga fushata (posterë, afishe, gota, strajca, çakmakë, stilografë me logon e fushatës) nëpër amvisëritë në komunën e Jegunovcit, si dhe gjatë takimeve informative me banorët, të organizuara në bashkëpunim me bashkësitë lokale.
Në fundtë fushatës u organizua ngjarje edukative për nxënësit e shkollave fillore nga Jegunovci, Zhliçeja dhe Shemshova. Nxënësit morën pjesë në aktivitetet edukative në vizatim, letërsi dhe kuis në temën “Ujë – do të thotë jetë”. Në këtë ngjarje morën pjesë rreth dyzet pjesëmarrës.



Orët edukative u vizituan masovikisht dhe u pranuan me enuziazëm të madh

“Uji është jetë e çdo njeriu në gjithë botën. Çdo pikë ujë vlen sa një pasuri, por për fat të keq në vendin tonë dhe rrethinën tonë shfrytëzohet pa kuptim. Nëse njerëzit nuk e kanë këtë ujë që e shpenzojnë pa kuptim do të paraqiten sëmundje në trupin tonë”, shkroi në punimin e saj Brankica Bëëazhevska, nxënëse e klasës së tetë nga SHF “Aleksandar Zdravkovski” nga Jegunovci.
“Uji në fshatin tonë nuk është aq i mirë. Kur kemi nevojë për ujë shkojmë dhe mbushim në ndonjë fshat fqinj. Uji i cili nuk është në rregull mund të krijojë sëmundje të ndryshme. Sot e drejta për ujë të shëndoshë është parakusht për të drejtën për jetë”, shkroi Leonora Jonuzi nga shkolla fillore nga Shemshova.
Në fund të ngjarjes të gjithë fëmijëve iu ndanë dhurata.

# SUNDIMI I MIRË, PJESËMARRJA DHE POLITIKA TË DREJTUARA DREJT NJERËZVE

## SUNDIMI I MIRË NË MAQEDONI

Qëllimi i programit është përgjegjësia e rritur e institucioneve, organizatave qytetare dhe qytetarëve.
Në këtë vit me aktivitete u përfshinë rrjetet Maqedonia pa diskriminim, Platforma qytetare e Maqedonisë dhe Koalicioni për gjykim të drejtë. Ato mbajtën punëtori ku i identifikuan çështjet e rëndësishme për ato. Për ato pastaj u përgatitën analiza komparative nga ane ekspertëve. Analizat rezultuan me plane aksionare. Për organizatat anëtare të koalicioneve u organizuan edhe vizitë studimi në Londër dhe trajnim për krijimin e politikave.
Në vitin 2009 vazhduan aktivitetet e filluara në kuadër të "Forumet në bashkësi" në Manastir, Resnjë dhe Karbinc, ndërsa filluan me punë edhe në komunat e Aerodromit, Radovishit/Konçes dhe Berovës.

## SI TË INKUADROHEMI NË KRIJIMIN E POLITIKAVE

Përfaqësues të koalicioneve: Maqedonia pa diskriminim (MBD), Platforma qytetare e Maqedonisë (GPM) dhe "Të gjithë për gjykim fer dhe të drejtë" patën mundësinë të marrin pjesë në trajnimin "Avokimi dhe lobimi  për inkuadrim në krijimin e politikave".

"Inkuadrimi i qytetarëve dhe organizatave qytetare në krijimin e politikave ishte aktivitet i dyanshëm: edhe nga qeveria, por edhe nga organizatat qytetare", thotë Emina Nuredinoska, trajnuese.

Pjesëmarrësit patën mundësi ti dëgjojnë përvojat nga Britania e Madhe dhe atë bashkëpunimi i organizatave qytetare me institucionet shtetërore, mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi dhe standardet për gjykim fer dhe të drejtë. "Veçanërisht më pëlqeu prezantimi i përvojës nga Londra", deklaroi Katerina Koneska nga GPM, kjo ishte mundësi që të shihet se si funksionon sistemi anglez". Këto përvoja ishin shumë interesante edhe për Gjorgji Joshevski nga Të gjithë për gjykim të drejtë. "Më pëlqu përvoja nga Londra, por kuptova se sa larg janë nga ne. Reformat që i kanë pasur në vitin 2006, për ne janë shumë të largëta. Mendoj se ndryshime duhet të kemi, por këto të bëhen me cilësi, që mos të hasin në korrigjime të shpeshta", shtoi Gjorgji.
Një pjesë të sesioneve të trajnimit iu kushtuan kornizës ligjore në Maqedoni dhe të përvoja të deritanishme në këtë fushë. "Jam e kënaqur nga i gjithë trajnimi", thotë Katerina,. "lojërat që i luanim zgjuan interesim te të gjithë ne dhe prandaj mendoj se bile edhe teoria mund të prezantohet përmes ushtrimeve".

Si pjesë e kursit për avokim dhe lobim pjesëmarrësit morën kaluan nëpër identifikimin e çështjes ose problemit për të cilin do të avokohet ose lobohet, nëpër qëllimet, partneritetet dhe aleancat që do të bëhen, përmes ballafaqimit me fuqinë, më tej biseduan për inkuadrimin në krijimin e politikave, vetë krijimin e politikave dhe në fund vetë analizuan policy paper të përgatitura.



Një pjesë e pjesëmarrësve në njërën nga ushtrimet praktike gjatë trajnimit

## FORUMET NË BASHKËSI

Në vitin 2009 me qëllim që të vendosen qasje participative për caktimin e nevojave prioritare në bashkësi, MCMS realizoi aktivitete në 6 komuna. Në të vërtetë, vazhduan aktivitetet e filluara në Manastir dhe Resnjë, si dhe filloi me punë në komunat e Aerodromit, Radovishit/Konçes dhe Berovës.

Në vitin 2009, u mbajtën 5 sesione të forumeve në resojë dhe 5 në Manstir. Banorët e Resnjës votuan për projektin "Përmirësimi i furnizimit me ujë në Prespë", derisa banorët e Manastirit për kompleksin sportiv në oborrin e shkollës në f. Kishavë dhe për projektet Tumbe Kafeja – infrastruktura themelore, Tumbe Kafeja – kompleksi rekretaiv sportiv dhe Tumbe Kafeja – monumenti kulturor historik dhe mundësi.



Qytetarët e Manastirit e përshëndetën zgjedhjen e projekteve prioritare që do të financohen me mjete nga programi

Komunat e Aerodromit, Radovishit/Konçes dhe Berovës ishin pjesë e ciklit të ri.

Në Berovë u zbatua forumi buxhetor, ku banorët morën pjesë në dhënien e propozimeve për inkuadrim në programin vjetor të komunës së Berovës për vitin 2010.

Në Radovish dhe Konçe u zbatua forumi ndër komunal, ku banorët nga dy komunat zgjedhin problemet që i prekin të dy komunat. Ata për temë zgjodhën "Furnizimi e ujë dhe ujërat e zeza".

Në komunën e Aerodromit pjesëmarrësit vendosën për temën e forumit "Përmirësimi i kushteve për shkollim dhe punë në shkollat fillore dhe kopshtet fëmijëve", ku diskutuan për konceptet e tyre për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në institucionet arsimore-edukative.



# SHOQËRI CIVILE E RRËNJOSUR DHE DINAMIKE

## ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i programit është rrethina mundësuese për funksionim efektiv të organizatave qytetare.

Në vitin 2009 MCMS vazhdoi të marrë pjesë aktive në punën e grupit punues për përgatitjen e ligjit të ri për shoqatat dhe fondacionet. U organizua prezantimi i Raportit për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil, u mbajt takim i Komitetit këshillëdhënës për realizimin e Civikus – Indeksi i shoqërisë civile (IGO), ndërsa në Bruksel, u mbajt mbledhja e parë e Komitetit të përbashkët konsultativ të Komitetit ekonomik dhe social evropian (EESK) me Republikën e Maqedonisë (KPK).
Në temën "Ndërtimi i kapaciteteve për BE financim" u organizuan 9 trajnime për 190 pjesëmarrës. Tetë nga trajnimet u realizuan për organizatat kosovare qytetare. U organizuan edhe trajnime për: qasje deri te fondet e BE, për marrëdhënie me opinionin, për menaxhim me resurse njerëzore, për strategjinë për qëndrueshmëri financiare, trajnimi për trajnues dhe për shkathtësitë e prezantimit. Në trajnimet morën pjesë 83 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave qytetare dhe institucioneve tjera.

### PËRGATITET LIGJI I RI PËR SHOQATA DHE FONDACIONE

MCMS i është përkushtuar përmirësimit të kornizës juridike për shoqërinë civile nga viti 195 dhe merr pjesë në grupin punues të Ministrisë së Drejtësisë, që jep kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e tekstit të ligjit të ri.
Pas intensifikimit të aktiviteteve, në qershor të vitit 2009, grupi punues mbajti punëtori treditëshe në Mavrovë, ndërsa MCMS vazhdoi me pjesëmarrjen e saj aktive dhe mbështetjen e grupit punues. Pas progresit në përgatitjen e tekstit të arritur në këtë punëtori, anëtarët e grupit punues nga MCMS morën për obligim përpunimin e dispozitave nga propozim ligji.
Grupi punues mbajti gjashtë takime. Në këtë periudhë u mbajtën edhe disa mbledhje koordinative bilateral me Fondacionin Instituti Shoqëria e Hapur Maqedoni (FISHHM), Qendrën Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL) dhe Ministrinë e Drejtësisë.



Në një nga mbledhjet e grupit punues që punoi në testin e propozim Ligjit

Me Ligjin e ri për shoqata dhe fondacione priten disa risi. Personat fizik dhe juridik, shtetasit e huaj dhe nga vendi dhe të miturit do të kenë mundësi nën rrethana të caktuara të themelojnë shoqatë. Propozim-ligji lejon edhe shoqërim joformal. Një nga risitë më të mëdha dhe më të rëndësishme për qëndrueshmërinë e sektorit civil është mundësia që organizatat të realizojnë të ardhura, të cilat duhet të shfrytëzohen për qëllimet e organizatës. Në këtë drejtim duhet të jetë edhe vendosja e statusit të organizatës me interes publik. Një pjesë e risive siç është vendosja e fjalorit të shprehjeve të përdorura, dispozita më të qarta të përgjithshme për fondacionet, si dhe pushimi i punës së organizatave, janë edhe sqarimi i dispozitave të Ligjit ekzistues për shoqata dhe fondacione.

Krahas plotësimit të rregullativave dhe praktikave ndërkombëtare, ligji i ri do të orientohet edhe drejt zgjidhjes së pengesave dhe problemeve të përditshme në zhvillimin e shoqërisë civile.

## FILLOI ME PUNË KPK PËR SHOQËRINË CIVILE TË BE DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Më 25 shtator 2009, Komiteti ekonomik dhe social evropian (KESE) ishte nikoqir i Komitetit të parë të përbashkët konsultativ (KPK) i shoqërisë civile të BE dhe Republikës së Maqedonisë. KPK është trup i përbashkët konsultativ që ka për qëllim ti vëzhgojë marrëdhëniet mes BE dhe Republikës së Maqedonisë nga pikëpamja e shoqërisë civile. KPK do ti promovojë kontaktet dhe diskutimin mes përfaqësuesve të shoqërisë civile nga të dy anët për çështjet me interes të përbashkët.



Nga mbledhja inauguruese e KPK në Bruksel

Anëtarët e KPK e përshëndetën propozimin e Komisionit Evropian për udhëtimin pa viza për qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe i ftoi institucionet tjera në BE ta ndjekin shembullin e tij. Anëtarët e KPK gjithashtu kërkuan sa është e mundur më shpejtë ti fillojnë negociatat mes BE dhe Republikës së Maqedonisë, menjëherë sa të plotësohen kushtet e caktuara në Partneritetin për qasje. Në këtë mbledhje u miratuan më shumë përfundime.

Këtë trup të porsaformuar të përbashkët e përbëjnë 12 përfaqësues nga shoqëria civile nga BE dhe Republika e Maqedonisë. Anëtarë të delegacionit maqedonas janë Mile Boshkov dhe Lidija Grupçeva – përfaqësues të punëdhënësve; Vanço Muratovski dhe Sllobodan Antovski – përfaqësues të sindikatave dhe Sasho Klekovski dhe Darko Aleksov – përfaqësues të interesit të përbashkët (të ndryshëm).
Ko-kryetar të KPK janë Vlladimira Drballova nga pala evropiane dhe Sasho Klekovski nga pala maqedonase.



# DIVERISIFIKIM I PRANUAR KULTUROR, NDËRVARËSI DHE DIALOG

## MAQEDONIA – MODEL PËR DIALOG TË KULTURAVE

Qëllimi i programit është përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike nëpër institucionalizimin e modeleve të suksesshme.
Në kuadër të aktiviteteve të dedikuara për mbështetje të këshillit ndërreligjioz në Maqedoni, u realizuan trajnimet: për marrëdhënie me opinionin, për qasje deri te fondet e BE dhe përgatitje për aplikim dhe për udhëheqje me resurset njerëzore për 37 përfaqësues të bashkësive fetare. U zbatua edhe një vizitë studimi në Holandë për studentët e Fakultetit Ortodoks dhe të Fakultetit të Shkencave Islame. Me programin u mbështet edhe mirëmbajtja e ueb faqes të Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë fetare. Një pjesë e programit ishte edhe analiza e gjendjes së bashkësive jo shumicë. Në bashkëpunim me Asociacionin për iniciativa demokratike (ADI) u seleksionuan komunat e Gostivarit, Kërçovës, Strugës dhe Dibrës, ku u vëzhguan mbledhjet e këshillave të këtyre komunave dhe u vëzhgua procesi i aplikimit të Rregullës së Badinterit gjatë vendimmarrjes, të cilat kanë të bëjnë me kulturën, gjuhën dhe identitetin, dhe në të njëjtën kohë u analizua edhe puna e Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive.
MCMS dhe Mediacioni Irlanda Veriore (MNI) e filluan projektin "Ura – lidershipi qytetar përmes dialogut ndërkombëtar".

### "URA" MES MAQEDONISË DHE IRLANDËS VERIORE

Përmes të mësuarit dhe rrjetëzimit do të adresohen çështjet e segregacionit përmes krijimit dhe zhvillimit të lidhjeve ndërkombëtare, shkëmbimit të praktikave të mira dhe forcimit të mediatorëve lokal me përvojë ndërkombëtare. Kjo është idea e projektit URA që në periudhën 2010-2012 do ta zbatojë MCMS dhe Mediation Northern Ireland (MNI) nga Belfasti, me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian, gjegjësisht Programi evropian për zhvillim rajonal "Investo në ardhmërinë tënde".



Sasho Klekovski flet në promovimin e projektit "Ura" në Parlamentin e Irlandës Veriore

Ideja për projektin bazohet në ngjashmëritë e konteksteve të Maqedonisë dhe Irlandës Veriore, duke përfshirë edhe konfliktet dhe marrëveshjet për zgjidhjen e tyre (Marrëveshja e Ohrit dhe e Pashkëve), si dhe përvojat e MNI dhe të MCMS-së nga aktivitetet paraprake.

Projekti ka tre shtylla. MCMS do të inkuadrohet në të parën – shkëmbimi transnacional i praktikave të mira. Janë paraparë gjashtë vizita shkëmbimi mes Maqedonisë dhe Irlandës Veriore dhe rajonet kufitare të Republikës së Irlandës. Vizitat janë kushtuar temave: policia, vetëqeverisja lokale, feja, mediat, rinia, strehimi.

Projektin e promovuan dy deputetë të Kuvendit të Irlandës Veriore më 25 nëntor 2009. Ekspoze për projektin kishin Piter O'Rajli – drejtor i MNI dhe Meri MekAnulti – udhëheqëse e projektit, ndërsa prezantim për Maqedoninë kishte Sasho Klekovski – Drejtor i parë ekzekutiv i MCMS.

# PROCES I MBËSHTETUR EUROINTEGRUES DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

## MENAXHIMI ME RRJETIN BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Rrjetin Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) e përbëjnë 12 organizata qytetare nga 9 vende të rajonit të Ballkanit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Romania, Sllovenia dhe Serbia. MCMS e udhëheq zyrën ekzekutive të BCSDN.

### HAP HISTORIK – BCSDN U REGJISTRUA SI SUBJEKT JURIDIK

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) pas tetë vitesh, kur filloi si pilot projekt dhe pesë vite funksionim si rrejt, më 1 tetor 2009 u regjistrua si subjekt juridik. Në muajin korrik u mbajt kuvendi themelor ku u miratua Statuti dhe Orientimi strategjik 2009-2011 dhe u zgjidh Këshilli, Bordi dhe Drejtori ekzekutiv.



Pjesëmarrësit e Kuvendit themelues të Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Themelues të Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile janë 11 organizata nga Ballkani: Fondacioni Shqiptar për Shoqëri Civile (Shqipëri), Qendra për Zhvillim të Organizatave Joqeveritare (Mali i Zi), Qendra për Servis Informativ, Bashkëpunim dhe Zhvillim të OJQ (Slloveni), Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (Bosnja dhe Hercegovina), Cenzura Plus (Kroaci), Iniciativat Qytetare (Serbi), Diakonia Agapes (Shqipëri), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (Kosovë), Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Asociacioni për Mundësi (Romani) dhe Asociacioni Vesta (Bosnja dhe Hercegovina).

Në kuvendin themelues u vërtetua se Zyra ekzekutive i rrjetit do të vazhdojë të punojë në kuadër të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS).

Drejtor ekzekutiv i BCSDN është Tanja Hafner Ademi.

# PARTNERITETI, MARRËDHËNIET ME OPINIONIN DHE MBËSHTETJA

## MARRËDHËNIET ME AKTORËT

Bashkëpunimi i MCMS zhvillohej me organizatat dhe institucionet e vendit, agjencitë anëtare të Këshillit Botëror të Kishave dhe me organizata tjera të huaja.

Platforma Qytetare e Maqedonisë (GPM) i vërtetoi qëllimet dhe drejtimet strategjike të GPM, ndërsa u miratua edhe raporti për zbatimin e programit për punë të GPM. Përfaqësuesit e MCMS, të zgjedhur nga ana e GPM, në mënyrë aktive morën pjesë në Komitetin e Përbashkët Konsultativ të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) me Republikën e Maqedonisë dhe Këshillin Nacional për Integrime Evropiane (KNIE).

MCMS është një nga iniciatorët e Aleancës Maqedonia pa diskriminim që u formalizua më 16 qershor 2009. Anëtarët punuan në mënyrë intensive në përgatitjen dhe lobimin për ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe me institucionet shtetërore ishte në nivelin e zakonshëm.

Këshilli Nacional për Integrime Evropiane (KNIE) ku anëtar është drejtori ekzekutiv i MCMS, Aleksandar Krzhallovski, si përfaqësues i GPM, vazhdoi në mënyrë aktive me punën e vet. U mbajtën 10 mbledhje të KNIE, ku u shqyrtuan, diskutuan dhe u vërtetuan përfundime dhe rekomandime për aktivitetet e Republikës së Maqedonisë dhe dokumentet për integrim në BE.

MCMS bashkëpunimin rajonal para së gjithash e realizoi përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, themelues dhe anëtar i së cilës është. Bahskëpunimi me Delegacionin e Komisionit Evropian dhe në përgjithësi me Komisionin Evropian në vitin 2009 u realizua përmes më shumë aktiviteteve, ku Delegacioni i Komisionit Evropian organizoi disa konsultime lidhur me Raportin për avancimin e Republikës së Maqedonisë, komponentin IPA, thirrjen për projekte në kuadër të EIDHR etj.

## MARRËDHËNIET ME OPINIONIN

Gjatë vitit 2009 u publikuan 12 numra të e-buletinit. Raporti vjetor u publikua në formë elektronike në CD) në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Në fund të vitit paraprak, MCMS e publikoi ueb faqen e re. Ueb faqja vazhdimisht azhurnohet, ndërsa një pjesë e përmbajtje publikohen edhe në mediat tjera sociale, në këtë mënyrë duke mundësuar dukshmëri më të madhe të MCMS-së.
Në vitin 2009 u realizuan gjithsej 100 prezantime/artikuj në mediat.

## MBËSHTETJA – MCMS I QËNDRUESHËM

Gjatë vitit u përgatitën dhe u shtruan 26 aplikacione deri 11 donatorë të ndryshëm, prej të cilave 10 u miratuan, 11 u refuzuan, ndërsa 6 janë në fazën e vendosjes. Tre aplikacione të cilat ishin në rrjedhë në fund të vitit 2008 nuk u pranuan.

## FUSHATA PËR MOBILIZIMIN E FONDEVE

Qëllimi i programit është kontributi drejt qëndrueshmërisë financiare të MCMS përmes forcimit të vetëdijes publike për problem të caktuar aktual dhe zbutja ose zgjidhja e tij.
Në vitin 2009 përfundoi zbatimi i programit. U botua Adresari i organizatave të mërgimtarëve dhe u publikuan dy hulumtime: Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve dhe Raporti ndaj verave tradicionale (sekulare) në Maqedoni.

### ADRESAR I PARË I ORGANIZATAVE TË MËRGIMTARËVE NGA MAQEDONIA

MCMS bashkë me Agjencinë e mërgatës së Republikës së Maqedonisë e publikuan Adresarin e parë të organizatave të mërgimtarëve nga Maqedonia.
Adresari ka për qëllim ta përmirësojë informimin për organizatat e mërgimtarëve nga Maqedonia, si mes tyre, ashtu edhe te opinioni i gjerë i Maqedonisë. Ai përmbledh informata për 584 organizata, nga gjithsej 25 vende.



Adresari do të jetë veglë e dobishme për komunikim ndër mërgimtarët

"Jemi të kënaqur nga ky hap i parë, por në të njëjtën kohë edhe të vetëdijshëm se Adresari ka vetëm kontakt informata për organizatat e mërgimtarëve dhe se në të ardhmen duhet të pasurohet", tha në promovim Aleksandar Krzhallovski, drejtor ekzekutiv i MCMS. Presim që kjo të jetë sfidë edhe për organizatat të cilat janë dhe ato që nuk janë pjesë e këtij botimi të parë, e kështu në të ardhmen të përgatisim Adresar, i cili do të ketë më shumë informata për vetë organizatat dhe aktivitetet e tyre", shtoi ai.
Në promovim mori pjesë edhe Metodija Koloski, kryetar i Diasporës së Bashkuar Maqedonase, organizatë e mërgimtarëve nga Maqedonia me seli në Uashington. "Jemi të kënaqur që fituam një botim të këtillë", tha gjatë promovimit Kosloski. "Diasporës i duhen informata të këtilla që ta lehtësojë komunikimin e ndërsjellë, dhe gjithsesi edhe për komunikim më të mirë të organizatave dhe qytetarëve nga Maqedonia me organizatat e mërgimtarëve", shtoi ai.

## KONTROLL I RI I PËRGJEGJËSISË SHOQËRORE TË QYTETARËVE

MCMS tashmë disa vite e hulumton përgjegjësinë shoqërore të qytetarëve. Kjo mundëson të shihen lëvizjet në shoqëri dhe planifikimi të bëhet në bazë të informatave të kontrolluara, në vend të në bazë të supozimeve.

Hulumtimi i ri tregon se fryma publike ka lëvizur drejt të maturës. Një pakicë e qytetarëve (40,4%) përmes pjesëmarrjes në protesta përpiqen t'i shprehin qëndrimet e tyre, ndërsa i vogël është interesimi edhe për inkuadrim aktiv në aktivitetet bamirëse në bashkësi (vetëm 27,4% janë qenë vullnetar në aksione të tilla).

Shumica e qytetarëve (51,9%) akoma e përjetojnë shtetin si më përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve shoqërore.

Besimi në solidaritetin e qytetarëve është rritur në 49,3% nga 39,3% në vitin 2007, ndërsa rritet edhe numri i njerëzve që dhurojnë nga 64,6% në vitin e kaluar, në 70,9% gjatë këtij viti.

Çdo i katërti qytetar është anëtar i ndonjë organizate qytetare, ndërsa gjysma prej tyre janë jo aktivë. Partitë politike mobilizojnë më shumë qytetarë. Qytetarët shpesh shoqërohen me anëtarë të familjes më të ngushtë/më të gjerë dhe miqtë.

Humbëse janë informatat për përgjegjësinë për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Vetëm një nga pesë qytetarë ndjejnë përgjegjësi për ruajtjen e mjedisit jetësor.

MCMS për herë të parë i hulumtoi raportet ndaj vlerave tradicionale (sekulare) në Maqedoni. Hulumtimi tregoi se Maqedonia është mjedis tradicionalisht ose social konzervativ. Mbështetja e vlerave tradicionale, gjegjësisht jo arsyetimin, është 58,9% për divorcin, deri 91,6% për homoseksualitetin. Kjo është vërtetuar edhe me Pasqyrën e vlerave botërore, gjegjësisht në Maqedoni forcohen vlerat tradicionale.



## ORGANIZATA

Në maj të vitit 2009 u zgjodh përbërja e re e Këshillit drejtues të MCMS. U zgjodhën 8 anëtarë nga 11 kandidatë të dominuar për anëtarë të Këshillit drejtues (KD). Rizvan Sulejmani u zgjodh për kryesues të KD, ndërsa Koço Angjushev për zëvendës kryesues. Në vitin 2009 u zbatua ede procedura për kompletimin e Bordit të drejtorëve. Komiteti dominues e dominoi, ndërsa Këshilli drejtues e zgjodhi Aleksandar Krzhallovskin për drejtor ekzekutiv të MCMS.

### KËSHILLI

- Ahmet Jasharevski
- Behixhudin Shehapi
- Bekim Ymeri
- Biljana Gerasimovska-Kitanovska
- Vlladimir Todoroviq
- Gazmend Ajdini
- Dilbera kamberovska
- Dushica Perishiq
- Dushko Kantarxhiev
- Gjoko Gjorgjevski
- Gjuner Ismail
- Elena Nikolova
- Zvonko Shavreski
- Ilo Trajkovski
- Jagup Selimoski
- Kelmend Zajazi
- Koço Angjushev
- Mihail Cekov
- Pepo Levi
- Rami Qerimi
- Ratko Llazarevski
- Rizvan Sulejmani
- Sllavko Velevski

### KD

1. **Rizvan Sulejmani,** kryesues, doktor i shkencave politike, drejtor Institutit për studime politike dhe ndërkulturore në Shkup

2. **Koço Angjushev,** zëvendës kryesues, doktor i shkencave teknike

3. **Biljana Gerasimovska-Kitanovska,** mjek i mjekësisë së përgjithshme, magjistër i neurologjisë, e punësuar në Qendrën klinike Shkup, anëtare e ESE-Shkup

4. **Behixhudin Shehapi,** kryetar i El Hilal, Shkup

5. **Goran Mihajlovski,** kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i “Vest”

6. **Gjoko Gjorgjevski,** Kisha Ortodokse Maqeedonase

7. **Jagup Selimoski,** Bashkësia Islame e Maqedonisë

8. **Sllavko Velevski,** kryetar i komunës së Mogillës

## PERSONELI

Në fund të vitit 2009, MCMS kishte 20 bashkëpunëtorë.

## ZYRA EKZEKUTIVE

Drejtor i parë ekzekutiv
**Sasho Klekovski**
skl@mcms.org.mk

Drejtor ekzekutiv
**Aleksandar Krzhallovski**
akr@mcms.org.mk

Grupi për zhvillim



**Dimçe Mitreski**
dmt@mcms.org.mk

***Miodrag Koliq**

Grupi për punësim



**Tetjana Llazarevska**
tlz@mcms.org.mk

**Llazar Nedanoski**
lnd@mcms.org.mk

**Gligor Mihaillovski**
gmh@mcms.org.mk

***Lirim Hajredini**

***Afërdita Musliu**

Grupi për shoqëri civile



**Emina Nuredinoska**
enr@mcms.org.mk

**Fatmir Bytyçi**
fbt@mcms.org.mk

**Valentina Çiçeva**
vch@mcms.org.mk

**Daniela Stojanova**
dsj@mcms.org.mk

**Krenar Kuka**
kkk@mcms.org.mk

***Sunçica Sazdovska**

Grupi për informata



**Gonce Jakovleska**
gjk@mcms.org.mk

**Gramoz Shabani**
gsb@mcms.org.mk

**Adis Rahiq**
arh@mcms.org.mk

**Boris Ristovski**
brs@mcms.org.mk

Programet ndër-sektoriale dhe ndërkombëtare
**Tanja Hafner-Ademi**
thf@mcms.org.mk

**Dervisha Haxhiq-Rahiq**
dhd@mcms.org.mk

***Zdenka Videnova**

Grupi administrativ
**Milka Bozhinovska-Miova**
mmv@mcms.org.mk

**Danilo Mitov**
dmv@mcms.org.mk

**Vesna Bogdanovska**
vbg@mcms.org.mk

***Mirjana Kunovska**

***Biljana Vuçureviq**

*personat te të cilët nuk është cekur e-mail adresa nuk janë më në marrëdhënie pune në MCMS

# MENDIMI I PAVARUR I REVIZORËVE

Deloitte.

Deloitte DOO
Mit. Teodosij Gologanov 28
1000 Skopje
Republic of Macedonia

Tel: +389 (2) 3111 300
Fax: +389 (2) 3119 544
cemkmacedonia@deloittece.com
www.deloitte.com/mk

Central Register of RM
Registry Number 4881427
Komercijalna Banka AD, Kej Dimitar Vlahov, Skopje
Acount no. 300-0000000910-22
VAT MK 4030994253680

**ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИТЕ РЕВИЗОРИ**

**До Советот на Македонски центар за меѓународна соработка**

Извршивме ревизија на приложените финансиските извештаи (стр. 3 до 28) на Македонски центар за меѓународна соработка (во понатамошниот текст "МЦМС"), кои се состојат од извештајот за финансиската состојба на ден 31 декември 2009 година и билансот на приходи и расходи, извештајот за промените во главнината и извештајот за парични текови за годината што тогаш завршува и преглед на значајни сметководствени политики и останати белешки кон финансиските извештаи.

*Одговорност на раководството за финансиските извештаи*

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување. Оваа одговорност вклучува: дизајнирање, имплементирање и одржување на интерна контрола која што е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали истото е резултат на измама или грешка, избирање и примена на соодветни сметководствени политики, како и правење на сметководствени проценки кои што се разумни во дадените околности.

*Одговорност на ревизорот*

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја извршивме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија. Овие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања, да ја планираме и извршиме ревизијата на начин кој ќе ни овозможи да добиеме разумно уверување дека финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува спроведување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од значајно погрешно прикажување во финансиските извештаи, настанато како резултат на измама или грешка. При проценувањето на овие ризици, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на МЦМС со цел дизајнирање на ревизорски постапки коишто се соодветни на околностите, но не за цел на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на МЦМС. Ревизијата исто така вклучува и оценка за соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Веруваме дека ревизорските докази кои што ги имаме прибавено се доволни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

*Мислење*

Според наше мислење финансиските извештаи ја прикажуваат реално и објективно, во сите материјални аспекти, финансиската состојба на Македонски центар за меѓународна соработка на ден 31 декември 2009 година, како и резултатите од работењето, промените во главнината и паричните текови за годината што тогаш завршува во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување.

Делоит ДОО

Лидија Нануш
Овластен ревизор
Директор

Јовица Стојчевски
Овластен ревизор

Скопје
9 март 2010 година

# RAPORTI FINANCIAR 2009

## BILANCI I KONSOLIDUAR I GJENDJES MË 31 DHJETOR 2009

(në mijëra denarë maqedonas, 1EUR=61.1741 denarë)

| Përshkrim | Vërejtje | 2009 | 2008 |
|---|---|---|---|
| A. MJETE | | | |
| **Mjete jo rrjedhëse** | | | |
| Patundshmëri dhe pajisje | 12 | 13,970 | 14,907 |
| Depozitë afatgjatë | 13 | 7,696 | 7,662 |
| Investime afatgjate | 14 | 660 | 350 |
| **Gjithsej mjete jo rrjedhëse** | | **22,326** | **22,919** |
| **Mjete rrjedhëse** | | | |
| Huazime afatshkurtër | 15 | 38,500 | 16,700 |
| Kërkesa nga blerësit dhe kërkesa të tjera | 16 | 14,589 | 12,136 |
| Të holla dhe ekuivalent në të holla | 17 | 49,156 | 75,365 |
| **Gjithsej mjete rrjedhëse** | | **102,245** | **104,201** |
| **GJITHSEJ MJETE** | | **124,571** | **127,120** |
| B. PJESA KRYESORE DHE OBLIGIME | | | |
| **Pjesa kryesore** | | | |
| Fondet | 18 | 99,749 | 106,132 |
| Teprica e shpenzimeve mbi të ardhurat për vitin | 18 | (1,212) | (6,383) |
| **Gjithsej pjesa kryesore** | | **98,537** | **99,749** |
| **Obligime jo në rrjedhë** | | | |
| Rezervime për dobi të punësuarve dhe shpërblime jubilare | 19 | 416 | 342 |
| **Obligime në rrjedhë** | | | |
| Obligime ndaj furnizuesve dhe obligime tjera | 20 | 1,418 | 2,250 |
| Të ardhura të anuluara | 21 | 14,421 | 18,081 |
| Shpenzime të llogaritura | 22 | 9,779 | 6,698 |
| **Gjithsej mjete në rrjedhë** | | **25,618** | **27,029** |
| **GJITHSEJ PJESA KRYESORE DHE OBLIGIMET** | | **124,571** | **127,120** |

## BILANC I KONSOLIDUAR I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE MË 31 DHJETOR 2009

(në mijëra denarë maqedonas, 1 ЕУР = 61,1741 denarë)

| Përshkrim | 2009 | 2008 |
|---|---|---|
| A.TË ARDHURA | | |
| **Donacione dhe grante** | | |
| Asociacioni norvegjez i komunave (KS) | 28,711 | 9,000 |
| Servisi zhvillimor kishtar (EED), Gjermani | 14,807 | 17,209 |
| Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) | 10,199 | 1,923 |
| Sokotab, Zvicër | 3,059 | 4,607 |
| Ndihma kishtare norvegjeze (NCA) | 3,009 | 2,814 |
| Filip Moris, SHBA | 2,936 | - |
| BE (Progres, EIDHR) | 1,390 | 4,807 |
| DANIDA/DCA | - | 2,768 |
| Të tjera | 4,288 | 1,823 |
| **GJITHSEJ DONACIONE DHE GRANTE** | **68,399** | **44,951** |
| **Të ardhura vetanake** | | |
| Të ardhura nga aktivitete tjera sociale dhe trajnimet | 3,964 | 7,571 |
| Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP) | 7,420 | 7,429 |
| Të ardhura nga mjetet e pashpenzuara pa obligim për kthim | 384 | 1,518 |
| Të ardhura nga kthimi i TVSH-së për programet sociale | 627 | - |
| Dallimet pozitive të kursit | 196 | 205 |
| Shpenzime për udhëtim të refunduara | 129 | 729 |
| Shpenzime të paguara të punësuarve | 112 | 679 |
| Dëme të paguara nga kompanitë e sigurimit | 32 | - |
| Dëme të paguara | - | 1,818 |
| Fitime kapitale nga shitja e pajisjes | - | 769 |
| Çregjistrimi i obligimeve | - | 198 |
| Teprica | - | 122 |
| Të tjera | 3 | 35 |
| **Gjithsej të ardhura vetanake** | **12,867** | **21,073** |
| Interes dhe dallimet pozitive të kursit | 5,740 | 2,850 |
| **GJITHSEJ TË ARDHURA** | **87,006** | **68,874** |
| B. SHPENZIME | | |
| **Shpenzime bamirëse** | | |
| Furnizimi me ujë i Jegunovcit (VOJ) | 28,951 | 6,129 |
| Zhvillimi lokal i bashkësive (LRZ) | 7,391 | 6,280 |
| Projekte për modernizimin e arsimit (PMO) | 5,187 | 4,310 |
| Maqedonia pa diskriminim (MBD) | 4,020 | 8,925 |
| Sundimi i drejtë në Maqedoni (DUM) | 3,682 | 380 |
| Model për dialog mes kulturave (MDK) | 2,235 | 0 |
| Zhvillimi institucional i shoq. civile (IRG) | 2,162 | 1,000 |
| Udhëheqja me Rrjetin ballkanik për OQ (RBM) | 619 | 703 |
| Fushata për mobilizimin e fondeve (KMF) | 451 | 3,182 |
| Programe të përfunduara në vitet e kaluara | 1,619 | 945 |
| Bashkëpunimi ndërreligjioz në Maqedoni (MSM) | - | 3,035 |
| Forcimi organizativ i aktorëve të SHC (ORR) | - | 2,271 |
| **Gjithsej shpenzime bamirëse** | **56,317** | **37,160** |
| **Shpenzime operative** | | |
| Rroga dhe shtesa për personelin | 17,372 | 20,226 |
| Shpenzime tjera operative | 13,510 | 16,618 |
| Informata dhe publikime | 625 | 885 |
| **Gjithsej shpenzime operative** | **31,507** | **37,729** |
| **GJITHSEJ SHPENZIME** | **87,824** | **74,889** |
| **BILANCI para tatimit** | **-818** | **-6,015** |
| Tatimi | -394 | -368 |
| **BILANCI** | **-1,212** | **-6,382** |

Botues
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Adresa e botuesit
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
rr. „Nikolla Parapunov” p.n.,
F.P. 55, 1060 Shkup
Republika e Maqedonisë

Tel.: 02/3065-381; faksi: 02/3065-298e-mail:
mcms@mcms.org.mk
www.mcms.org.mk

Drejtor i parë ekzekutiv
Sasho Klekovski

Drejtor ekzekutiv
Aleksandar Kërzhallovski

Redaktor përgjegjës
Gonce Jakovleska

Ndihmës redaktor përgjegjës
Gramoz Shabani

Fotografitë
Foto arkivi i MCMS

Dizajni
Koma lab.

МЦМС